



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 141, datë 30.07.2018**

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 37, DATË 28.05.2015**  
**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR PËRZGJEDHJEN E**  
**SHOQËRISË AUDITUESE PËR SHOQËRINË E SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**

**Në Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:**

1. Në nenin 3, në fund, shtohet shprehja “të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, në Republikën e Shqipërisë.”
2. Në nenin 4, pika 1, shkronja “b” dhe në pikën 2, shprehja “ekspert kontabël i regjistruar” zëvendësohet me shprehjen “auditues ligjor”.
3. Në nenin 5, pika 1:
  - 3.1 Në shkronjën “d”, shprehja “Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Regjistruar (IEKR)”, zëvendësohet me shprehjen “Vërtetim nga Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”;
  - 3.2 Pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “d/1”, me këtë përmbajtje:

“d/1) Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve)”;
  - 3.3 Në shkronjën “e”, në fund shtohet, shprehja “përfshirë certifikatën e aktuarit, si dhe kontratën për shërbimet aktuariale”;
  - 3.4 Në shkronjën “f”, pas fjalës “vërtetim”, shtohet “i Organizatës profesionale të audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”;
  - 3.5 Në shkronjën “g”, pas shprehjes “në nenin 4, pika 1, shkronja “d”” shtohet, shprehja “ dhe pika 2, shkronja “b””;
4. Në nenin 6:
  - 4.1 Pika 1, shprehja “jo më vonë se data 30 korrik”, zëvendësohet me shprehjen “jo më vonë se data 31 korrik”;
  - 4.2 Pika 3, shprehja “brenda 1 (një) muaji”, zëvendësohet me shprehjen “brenda 2 (dy) muajve”.